

NIKOLETA KALLDRËMXHIU

**RRETH NJË ANKETIMI PËR NJË ESE LETRARE
NË KLASAT E PESTA TË QYTETIT TË BERATIT**

Qëllimi i këtij mëtimi të shkurtër është nxjerrja në pah e një aspekti të veçantë të semantikës fëminore si mundësi për kultivimin e shqipes letrare. Edhe pse drejtimi i punës sonë kërkimore, përgjithësisht, është produkti letrar, marrim përsipër të informojmë shkencërisht nëpërmjet një anketimi vjeljen leksikore për një nga konceptet kyçe të njeriut, atë të bukurisë. Pse e ardhmja e fjalës shqipe e ka burimin te nxënësit tanë, e zhvilluam këtë anketim me nxënësit e klasave të pesta të qytetit të Beratit. *E bukura* është kërkuar të nxirret e gjallë ashtu siç shfaqet në ligjërim gjë që përbën “frymën” e përdorimit të saj¹, pa kaluar në dukuri të veçanta.

Fjalësi i fëmijës ruan masën e sugjestionimit dhe të qartësisë. E parë midis hipoligjërimit² (me elementet e aspektit informativ), që zbulon nivelin e parë të përkufizimit gjuhësor të fjalës dhe hiperligjërimit (me përdorim konotativ, shprehës të gjuhës), mënyra e perceptimit të fjalës është parë në një mjedis gjuhësor dhe jashtëgjuhësor. Këto të dhëna i kemi perifrashuar në një krijimtari eseistike, e cila mund të shërbejë si pikë referimi për krijuesit dhe lexuesit e vegjël e të rritur.

Qëllimi modest i punës sonë i përgjigjet një aspekti metodik të mësimin sot të shqipes që është integrimi lëndor, ku të dhënat nga konceptet bazë nga gjuha shqipe integrohen në mënyrë organike në letërsi.

Nga ana tjetër është fakt se pasuria e fjalorit është kusht bazë për një krijimtari të arrirë letrare. Edhe pse vjelja leksikore është bërë për një fjalë të vetme, do të sjellim shembuj për dobinë e saj në punët e pavarura më shkrim të nxënësve nga klasa e pestë deri në shkollën e mesme.

Kjo është konceptuar si një anketë tip e cila mund të shtrihet edhe me koncepte të tjera kyçe. Anketimi në bazë të të cilës u regjistrua lënda leksikore pati në bazë katër pyetje, por që kishin edhe nënpyetje që t'i shërbenin sa më mirë drejtimit të zgjedhur për t'u paraqitur. Siç e thamë edhe më lart anketa i përket moshës 11- vjeç në qytetin e Beratit, dhe një

¹ N. Kalldrëmxhiu, *Fjala zemër në gjuhën shqipe* (mikrotezë masteri në dorëshkrim, udhëhequr nga prof. dr. J. Thomai), Tiranë 1996, f. 72.

² V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë 2015, f. 192.

ngushtësi e tillë përta i përket vendit, nuk i shkakton probleme qëllimit tonë të studimit. Për këtë anketë janë zgjedhur nxënës që i përkasin nivelit të përparuar pa dallime social-kulturore.

Anketa është mbështetur në aktivizmin e fjalëve, të folurit dhe të shkruarit të fëmijëve të kësaj moshe, i cili bëhet nëpërmjet togfjalëshave dhe fjalive. Për të parë njohjen intuitive të tyre është kërkuar se cila fjalë është e ngjashme me *e bukur dhe mbi hamendësimin kontekstual, me fragmente të nxjerra nga tekstet mësimore*. Pasurimi i fjalorit të nxënësit do të përbënte një qëllim më vete të punimit. Folësit janë trajtuar si individë psiko-socialë.

Pasi e kemi hetuar shkallën e njohjes nga kjo grupmoshë, mund të themi se njohja më e madhe qëndron në aspektin afektiv të fjalës që lidhet me kënaqësinë, argëtimin, dhe simpatiken. Kësaj fjale ata (fëmijët) nuk mund të japin një shpjegim të plotë, ndërsa pyetjes për ndonjë fjalë të afërt sillet fjala *simpatik, mirë* dhe tipike për moshën është fjala *bukurosh* me prapshitesën përkëdhelëse -sh *bukuroshe* dhe më pak njihet fjala *zbukuroj* me parashtesën përforcuese z-. Kuptimi i saj nxirret nga përdorimi në fjali. Meqënëse fjalët *e mirë* dhe *e bukur* konsiderohen si pjesë plotësuese të njëra-tjetrës dhe të shkrira konceptohen në fraza të tilla *tipike si: sjellja e zburon njeriun apo çdo njeri e ka diçka të bukur*.

Por, vërehet se kjo njohje nuk është gjithnjë e specifikuar sidomos në përdorimet proverbiale. Shpesh ata i shpjegojnë këto kuptime me një përzjerje brenda kësaj fraze proverbiale me një lloj lidhjeje kuptimore që ato nuk e kanë. Kështu në shembullin: “komento titullin e tregimit: *E bukura dhe e mira s’kanë fund*” – që pa lexim sillet si: *që shumica e njerëzve janë të mirë dhe të edukuar dhe bujarë, rast tipik* ku këto fraza vlerësohen gjuhësisht të rregullta, por për nga kuptimi do të ishin të parregullta. Gabime të tilla qëndrojnë pikërisht se *e mira dhe e bukura* perceptohen shpesh si e njëjta fjalë. Përveç përdorimit të pasaktë të kuptimit proverbial a mund të kërkohej edhe një arsye tjetër? Një përzjerje e tillë shmang kuptimin e fjalës *i bukur* që lidhet me *të përsosurën*. Mbas hamendësimit kontekstual nxënësi vjen më afër kuptimit të fjalës *i bukur* që ai e lidh me: *ai mësoi, u bë me intelekt*.

Ndërsa për shpjegimin e kësaj fjalë me fjalë të tjera përqendrohet si fjalë të ngjashme ata njohin: *e mirë, simpatik, bukurosh*. Vëmë re se njohja e drejtpërdrejtë me fjalët e të njëjtës rrafsh është e dobët. Njohja e fjalës nëpërmjet kuptimit të kundërt të saj sjell tre çifte antonimike: *i bukur ~ i shëmtuar dhe i bukur ~ i shpifur, e bukur ~ e keqe (dëmtuese)*. Kjo e fundit

është nxjerrje nga konteksti, kuptimit të kësaj fjale që bukuria ngadonjëherë të dëmton (Migjeni *Bukuria që vret*) është perceptuar kështu nga fëmijët.

Bukuria në të shumtën e rasteve konceptohet si objekt dhe kjo jepet në ndërtimet e krahasimeve, p.sh.: *e bukur si flutur, i bukur si lepurush, bukuria jote si deti, mami e bukur si trandafil, gjuha shqipe është e bukur si kënga, i bukur si dielli* etj. Në shembuj të tjerë, si: *lulet janë rritur për bukuri~ mire, sa rritej e zbukuroj ~ ndryshon, lojë e bukur ~ argëtim, e bukura e dheut ~ si përrallë, personazh, fjala ka përdorime kontekstuale. Ndërsa njësitë frazeologjike njihen pak prej kësaj grupmoshe.*

Në të shumtën e rasteve reagimi kundrejt shenjës gjuhësore dhe asaj jogjuhësore është ai i parë i fjalës që lidhet me vlerësim e aspektit fizik të jashtëm të njerëzve dhe objekteve.

Një bllok pyetjesh me të cilat kërkohet të dihet se çfarë përfaqëson dhe ç'ndiejnë nxënësit kur shikojnë një send të bukur nëpërmjet figurave³ ose pamjeve konkrete, vetëm e kemi evidentuar si produkt, sepse kjo nuk i përket gjuhësisë, por semiologjisë.

“Shiko në figurë ose në ambient, pastaj shprehu ose vepro: *çfarë ndjeni apo shikoni një abazhur, ~ndriçim, kënaqësi, lumturi e ndjen veten mire b)* e cila përkon me njohjen e kuptimit të dytë të fjalës që ka sjell gëzim e lumturi c) kur shikon një veshje popullore ~ *e mire d)* një pjatë e zbukuruar me copa pjeshke ~ *lë lojën, nxit e)* dyqan lulesh ~ *e mrekullueshme.*”

Reagimi përkundrejt shenjës gjuhësore dhe jogjuhësore, përjetohet si afektiv, që tregon se fjala krahas denotacionit, fjala ka dhe një konotacion të zhvilluar.

Leksikun shkollor të përfutur nga kjo vjelje e rendisim në një varg sinonimik⁴ që i përkasin fjalëve të të njëjtit rrafsh: *simpatik, bukurosh * e këndshme, argëtuese, lojë e bukur, * mirë vishet bukur, sjellje e bukur * e mirë gjuha jonë është e bukur * e mrekullueshme buzëqeshja e bukur e nënës *e shndritshme dritë e bukur * talent sa bukur këndon drita * e shëndetshme sa fëmijë i bukur, ku fjala më e largët në vargun sinonimik është më e dobët, por për të krijuar secili mund ta zgjedhi vetë fjalën që e specifikon më mirë kuptimin. Përgjithsisht për një fëmijë të kësaj moshe e bukur do të thotë: *shumë e mirë për t'u dëgjuar, për t'u parë, për t'u**

³ Vlerësimi kombëtar në matematikë dhe gjuhë shqipe 2016, f. 17.

⁴ Miço Samara i kushton vëmendje të veçantë vargut të fjalëve sinonimike, i cili përdoret për të rritur intesitetin e shprehjes.

shijuar. Vërejmë se fusha tematike e botës shpirtërore te fëmijët lidhet me mikrofushën e fjalëve që emërtojnë objekte.

Siç e dimë gjuha shqipe, falë sinonimisë së saj të zhvilluar, ofron mundësi për t'i zhfrytëzuar si burim i stilit. Pranëvënia e sinonimeve pranë njera - tjetrës, kur ato vetë dallohen nga shkalla dhe intesiteti është një mjet stilistik, i cili përdoret shumë edhe nga shkrimtarët tanë. Vargu i mundshëm që mund ta japi këtë intesitet: *e bukur, magjepsëse, e shndritshme, e mrekullueshme*.

Është vënë re se fjala *mirë* dhe sidomos kompozitat e formuara prej saj konceptohen dhe shpjegohen më lehtë. Ato i përkasin fushës tematike të fjalëve që emërtojnë cilësi e vlera shoqërore si: mirëqënie, mirëkuptim, mirënjohje, mirësjellje.

Në disa anketime vëmë re se prindërit e konceptojnë të *bukurën* si të *shëndetshme* që është koncept i njohur në kulturën tonë popullore.

Nëpërmjet anketimeve është vlerësuar potenciali i nxënësve, por në të ardhmen duhet të përballohet me një fjalor sinonimik për fëmijë, sepse vetëm 18.18% e të anketuarëve i mësojnë njohuritë e tyre mbi fjalorin në mënyrë të pavarur, jashtë mjediseve të klasës, ndërsa shumica mendon, se zgjerimi i njohurive mbi fjalorin arrihet, duke punuar në mënyrë të pavarur jashtë klasës ashtu si rekomandohet nga prindërit.

Një aspekt i vëzhgimeve tona që meriton të vlerësohet është se si fjala ashtu edhe objektet e bukura e nxitin fëmijën në veprime të dobishme, që që do të përbënte një sprovë për punën e mësuesve. Kjo është edhe arsyeja kryesore që ne zgjodhëm këtë fjalë, përveçse ajo është potenciale dhe e zhvilluar në drejtime gjuhësore dhe jashtëgjuhësore. Në përgjithësi anketimi ka sjellë të dhëna interesante që meritojnë një studim më vete.

Eseja

Pyetjet e drejtuara nxënësve të klasës së pestë na ndihmojnë për të formuluar: a) Shprehje e fjalor shkollor për këtë cikël, për tema të tilla si: *Sjellja e zbukuron njeriun / Nuk ka njeri pa diçka të bukur / E bukura dhe e mira s'kanë fund*.

Fjalor shkollor: i bukur nga shpirti; bukuria është si ..., jo i bukur nga pamja, por nga..., edhe ti do të jesh i bukur...; shkruaj bukur, nuk është dhe aq keq por..., që të bëhet i bukur si ti..., të isha si ti do ta bëja më të bukur ose duket e bukur, përfundoje ...etj.

Plotësimi i punëve me shkrim me detaje përshkruese: *e/i bukur si flutur, si lepurush, bukuria jote është si deti, dukesh si e bukura e dheut,*

mami im është e bukur si trandafil; oh, sa bukuri ka kopshti!, sa bukur është në pranverë! etj.

Një ese vlerësimi: *Shikoni një dyqan lulesh. Tregoni si janë lulet tuaja. Pse lulet tuaja janë rritur më mirë apo më keq se ato të dyqanit?*

Fjalor e leksik shkollor: *e ëmbël, dehëse, ngacmuese, kujdeset mjaft mire, kopsht i lulëzuar, shëndoshë e mirë, e freskët, e vyshkur, aromë, lulet janë rritur për bukuri, mirë se vini në dyqanin tonë, të gjitha lulet kanë dicka të bukur, sa keq për lulet..., sa mirë të kesh lule të bukura në kopsht.*

b) pyetje e përgjigje ese, paragrafë shpjegues, përshkrues, përkufizues në një ese letrare për AML.

I. Pyetje ese

Shembuj të pyetjeve ese të pazgjeruara a të kufizuara: *Çfarë është e bukur për fëmijën tuaj?*

Duhet të jetë e shëndetshme, pa të jetë e bukur. Në kulturën tonë popullore bukuria është barazuar shpesh me shëndetin.

Ese për njohuritë për lëndën:

Pyetje a përgjigje që kërkojnë përgjigje të kufizuara: Shembull 1. Komento titullin: Bukuria që vret të Migjenit.

Përgjigje e kufizuar: Ndonjëherë ajo që na duket e bukur na dëmton.

Shembull 2. Bukuria dhe shëmtimi janë tema të njohura në letërsi. Identifikoni disa nga autorë nga letërsia

*Përgjigje e kufizuar: Kjo temë është trajtuar nga Sh. Bodler dhe O. Wilde. **Pyetje që kërkojnë përgjigje të zgjeruara**⁵*

1. Të kuptuarit e koncepteve: identifikimi i shembujve, krijimi i shembujve

Lexoni *Bukuria që vret të Migjenit*. Çfarë e ilustron konceptin se bukuria ndonjëherë të dëmton

1. Analiza

Pyetje që kërkojnë përgjigje të zgjeruara: A të dëmton ndonjëherë bukuria? A mund të vendosim paralele midis konceptit të së bukurës te “Bukuria që vret” e Migjenit me atë të “Portreti i Dorian Gray” të O. Wilde” dhe “Bukuria” e Sh. Bodlerit?. Jepni shembuj të tjerë të ngjashëm.

Fillime fjalie: Nga një qëndrim praktik e bukura është nxitëse, megjithatë nga një pikëvështrim etik...

Shembull 2. A janë e bukura dhe e mira e njëjta fjalë. Si shfaqet ky koncept në letërsinë tonë të kultivuar dhe atë artistike?

⁵ B. Musai, *Të shkruajmë ese*, Qendra për arsim demokratik, Tiranë, 2007, f. 105.

Ndërtimi i konceptit të bashkuar të *së bukurës, së mirës* e gjejnë në ciklin tonë të kreshnikëve: “Bardh si drita tej Zana atëherë kan ardhë...” Kjo mendësi e gjejmë të shprehur edhe në përkufizimin e fjalës *mirë* në fjalorin e gjuhës shqipe. Të tillë e shohim edhe te Kërcimtarja e Dukagjinit ku figura e lules përshkruhet si Zana e Malit, që magjeps, e pakapshme si drita: *si drita në krue*. E bukura është më e mira jonë e trashëguar.

Shembull 2. Lexoni paragrafin e mëposhtëm. Për çfarë na ndihmojnë objektet në natyrë dhe ato të krijuara nga njeriu?

Qysh në moshë të vogël ngjyrat, filmi dhe ushqimi nxitin veprimtarinë tonë. A keni parë ndonjëherë një fëmijë që nuk e shijon lulëzimin e një kumbulle apo të një pjeshke, që rrokullis me dorë një toptë mandarine e kur mendon mendon se do të kullufisë dy a tri të tilla është gati të lërë lojën apo të fillojë mësimet?

Natyrisht kjo orë biologjike e ndan orën e studimit me atë të lojës. Njeriu, përveç natyrës, ka zgjedhur edhe shenja për të përshkruar atë që e rrethon, si mënyrën për ta përmirësuar këtë realitet. Ajo e nxit atë në veprimtari të dobishme dhe të domosdoshme për zhvillimin e tij, veçanërisht atij shpirtërore.

P.sh., dëshira për të pasur dritë në dhomë që i largon një fëmijë frikën nga vetmia dhe kujtimet e një dite jo të mirë dhe që do të ishte një abazhur sipas zgjedhjes së tij me një dritë të ëmbël. Natyrisht nuk është vetëm fjala që e nxit fëmijën të rritet e të flejë vetëm, por objekti konkret i vendosur bukur diku në një kënd të dhomës së tij. Kështu shenjat apo sendet na ndihmojnë jo vetëm ne, por pasurojmë gjuhën. Nëse fjala **dritë** do të thotë *shkëlqim, ndriçim, dritësim, nur; llambë* do t'i shtohet edhe *abazhur, që e nxit fëmijën në një veprimtari të dobishme*.

Kjo larmi fjalësh të ngjashme me *dritë* e bën punën e gjuhëtarëve të përgëzueshme dhe të letrarëve mbreslënëse.

Duke folur për sendet dhe natyrën e tyre te autorë si Koliqi e Xhoisi objektet dalin në një plan tjetër. Ata nxitin nënvetëdijen tonë, nevojën për të zbuluar një realitet më të thellë, më i fortë se shfaqja e gjërave. Shpirti i gjërave, identiteti i tyre shpërthen drejt nesh përtej velit të asaj që duket. Megjithëse dalin edhe objekte të pabukura si muri, apo hana e gjakut te koloiqi. Përvojat e fshehura në kujtesë, nxiten të dalin në sipërfaqe duke sjellë të gjitha hollësitë dhe emocionet që lidhen me të.

Shembull 3. Si do ta përkufizonit ju të bukurën?

Paragrafë shpjegues: *Fjalë të tilla si bukuria (historia e bukurisë. U. Eko) përkufizohen në mënyrë të ndryshme nga individë të ndryshëm, që lidhet jo vetëm me edukimin e tyre, por edhe me ndjenjat e tyre.*

Fjalorin e gjuhës shqipe e hapin sa herë na duhet të dimë më tepër Në këtë Fjalor bukuria përkufizohet kështu:

Bukuri, ~A(e) f.sh. ~, -të. 1. Të qenët i bukur, vetia e asaj që është e bukur; e bukura; tërësia e anëve dhe e tipareve të bukura të dikujt a të diçkaje. Pamja, cilësitë e virtytet e bukura.

2. kryes. sh gjë e bukur; anët dhe pamjet e bukura dhe tërheqëse të një vendi; poet qenie shumë e bukur nga trupi a nga ana shpirtërore.

Teza juaj: *Te shumica e njerëzve ajo lidhet me pamjen, si cilësia që na kënaq tekta shohim natyrën, pikturën, muzikën dhe gjërat e tjera fine. Te të tjerë lidhet me të mirën, por ato nuk janë e njëjta fjalë, Te fëmijët lidhet me argëtimin, të mrekullueshmen, talentin dhe i di pothuajse mirë kur bëhet 10 vjeç. Pra ai ndryshon në mënyrë të shkallëzuar dhe mënyra më e mirë për ta vëre është se si ne ua mësojmë fëmijve. Edukimi i një delikatese të tillë që çon në ndijime dhe në emocione më të holla. E fillojmë me një lule të bukur, me një film të bukur, me një këngë të bukur, me një lojë a fustan të bukur a më vonë me një që do të bëhet shef kuzhine me një pjatë të bukur.*

Informacion paraprak: Ulemi pranë tyre dhe e nxisim kur i dhurojmë një libër që flet për të Bukurën e dheut, për vajzën si drita, për djalin si yll gjë që i bën të ndihen mirë e të shijojnë kënaqësinë e zbukurimit prej artit.

Pjesa e përkufizimit tuaj për termin: Vë re se të shumë fëmijë, përkufizimi i të bukurës lidhet me objektet që i rrethojnë. Ata i shohin me kënaqësi të mëdha gjërat e bukura dhe mrekullohen pas tyre. Bile, për t'i nxitur mjafton t'u tregosh se kjo apo jo është e bukur, për t'u dëgjuar, për t'u pare a për t'u shijuar.

Paragrafë përkufizues: Por, shpesh duan të dinë më tepër. Kur isha fëmijë doja të dija nëse ishte e bukur ajo që vishja vizatoja apo shkruaja. Nuk e kuptoja pse mamaja e përkëdhelte gjyshen duke e quajtur bukuroshe dhe pse e di që ajo është plakë.

Po nëqoftëse unë sot do të thoja se e bukur është një fustan me lule është buzëqeshja e nënës, se një kopsht i bukur është përveçse i këndshëm dhe i mrekullueshëm, se kur flet bukur dukesh **simpatik**, **se kjo lojë e bukur ishte argëtuese, se kur këndon bukur je talent, se një fëmijë i bukur është i shëndetshëm a do t'i mësonim më mirë?**

Përfundimi: Ta përkufizosh bukurinë si diçka të përsosur, si harmoni, si ndjesi është një mundësi e vyer që t'i shtojmë jetës sonë gëzimet, por kjo nuk është e thjeshtë. Njëherë një fëmijë i mësoi një plaku të ndizte zjarrin. Ndaj fillimin e përkufizimit të së bukurës e nisim te fëmijët. Të lësh pa përkufizuar bukurinë e botës feminare është shkujdesje.

Si përfundim mund të themi se vjelja e fjalorit të gjallë dhe përdorimi i tij në punët e pavarura është mjaft e rëndësishme si pjesë e praktikës sonë mësimore. Nga ana tjetër anketa të tilla forcojnë dhe pasurojnë metodikën e mësimdhënies në punët me shkrim dhe mund të përdoren gjerësisht nga vetë nxënësit e ciklit të mesëm, për t'i integruar njohuritë e tyre gjuhësore në esetë letrare.

Shpresoj që në këtë punim të shkurtër të përlij sado pak mendimin për nevojën e një fjalori sinonimik për fëmijë për një të ardhme shumë e mirë të shqipes, duke evidetuar pikërisht disa aspekte të semantikës feminare si mundësi për kultivimin e shqipes letrare me njësi të reja leksikore.

Anketë tip

(Zhvilluar në klasat e pesta të qytetit të Beratit në maj 2016)

1. Çfarë do të thotë për ju fjala *I bukur*:

1.a çfarë mund të thuash kur dikush: këndon bukur/ flet bukur/luan bukur

1.b çfarë do të thotë *Lulet janë rritur për bukuri/ e bukura e dheut/Mirë e bukur*

2. Thuaj një ose disa fjalë të ngjashme dhe të kundërta me *i bukur*.

3. **a.** Komento titullin e tregimit: 2. a *E bukura dhe e mira s'kanë fund* dhe *Bukuria që vret*

3. **b** Si i kupton këto shprehje: *sjellja e zbukuron njeriun/ nuk ka njeri pa dicka të bukur/ rritej e zbukurohej*

3. **c** plotëso: *I/ e bukur si.../ Shtëpi e bukur si .../ Bukuria jote është si.../ Mami e bukur si.../ Oh, sa bukuri ka...Sa bukur është të...*

3. **d** Këto krahas ime të njohura çfarë do të thonë për ty: *Gjuha shqipe është e bukur si.../ E bukur si dielli/ E bukur si hëna ~/ E bukur si flutur ~*

4 .Shiko fotofrafitë. Thuaj çfarë të mendon dhe çfarë të pëlqen në to:

a) *një abazhur* b) *kostum popullor* c) *lulishte me një akvarium mjelmash*